

NJOFTIM
Nr. 20161, datë 2.11.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM, SI DHE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, kapitulli III, pika 16, shpallet për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në pronësi të Shoqërive Huamarrëse në Administrim

Nr.	Emërtimi	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
			Data	Ora	Vendi
1	Benz Mercedes	26 460	18.11.2022	10:00	DDPP
2	Fiat Albea	21 952	18.11.2022	10:30	DDPP

2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi	Viti prodhimit	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Kamion Volvo HYF 1018+ Rimorkio Crone SDP-24	1985	420 000	18.11.2022	11:00	DDPP
		1995				

3. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Objekt			Data	Ora	Vendi
1	Ndërtesë dykatëshe + papafingo	Grudë e Re, Shkodër	9 560 000	0	9 560 000	154.9		18.11.2022	11:30	DDPP

4. Në pronësi të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Asete			Data	Ora	Vendi
1	Asete të shoqërisë “ABA 2011” sh.p.k.	Fier	672 330,75	0	672 330,75			18.11.2022	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të shoqërive huamarrëse në administrim.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për shoqëritë huamarrëse në administrim, pasi të keni tërhequr pranë tyre faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.